

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË/DEGA MALISHEVË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit K. (M.) M. nga fshati R., Komuna e K., për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.661/2017, të datës 01.11.2017, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur më datën 28.12.2018, në prani të prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të akuzuarit K. M., më datën 03.01.2019 mori dhe publikisht shpalli këtë:

## AKTGJYKIM

I akuzuari K. M., i biri i M., i lindur më datën ..., në fshatin R., Komuna e K. ku dhe tani banon, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, më parë i pa dënuar, ka të kryer shkollën e Mesme, i pa martuar, i punësuar si kamerier, me numër personal ....

## Ë shtë fajtor:

Për shkak se:

Me datë 17.03.2017, rreth orës 12:20 min, në pyllin Publik– Rajoni i Ekonomiko Pyjor “D.” në vendin e quajtur “Udha e U.” me qëllim përfitimi të kundërligjshëm për vete apo tjetrin, e me qëllim vjedhje ka prerë me motorsharrë ilegalisht 210 copë dru të llojit “qarr e bung” të gjatësisë 3 m, e të trashësisë 7 cm, e në vëllim të përgjithshëm prej 2.10 m<sup>3</sup>, e të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi Pylltari e Zhvillim Rural– Njësia Pyjore Malishevë, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 336.00 €.

-me çka ka kryer veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1, të KPK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,41,49,50,51, 52 par. 5,73, dhe nenit 358 par. 1, të KPK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së i shqipton :

## DËNIMIN ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (4) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej një (1) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara Drejtoria për Bujqësi Pylltari e Zhvillim Rural- Njësia Pyjore Malisheve, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

### **Arsyetim**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën PP.nr.661/2017, të datës 01.11.2017, kundër të akzuarit K. (M.) M. nga fshati R., Komuna e K., për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPK-së, dhe ka propozuar që të akzuarin ta shpallë fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.28.12.2018, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar, me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë së shtetit.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit jep mendimin se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, andaj kërkon nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtor, ta dënoj në bazë të ligjit, për veprën penale më të cilën ngarkohet, si dhe ta obligoi në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

I pandehuri deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, ndien keqardhje për rastin që i ka ndodhur, njëherë deklarohet se ky ka qenë rasti i parë që ka ra ndesh me ligjin dhe i ka premtuar gjykatës se asnjëherë nuk do të bie ndesh me ligjin, megjithatë kërkoi falje dhe kërkon nga gjykata që gjatë matjes së dënimit të ia shqipton një dënim sa më të butë që është e mundur.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestar u vërtetua se ai me datë ,kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural- Njësia Pyjore Malishevë nr..../2017 e dt. 29.03.2017; Fletëparaqitja e rojtarit te pyllit nr...., të datës 17.03.2017.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarimin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarimin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë, sidomos për faktin se është hera e parë që ndeshet me ligjin mos ndëshkueshmëria e tij e mëparshme, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (4) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej një (1) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor, është marr konform nenit 450 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/DEGA MALISHEVË**  
**P.nr.373/17, më datën 03.01.2019**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Njazi MORINA**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimin të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes të kësaj Gjykate.